

Kushtet e përdorimit për video-telefoninë përmes Skype

Të burgosurve dhe të paraburgosurve sipas kërkesës mund t'u lejohet të përdorin video-telefoninë përmes Skype. Video-telefonja përdoret për të ruajtur, stabilizuar dhe mbështetur kontakte dinjitoze.

Për të qenë në gjendje të zhvillohet një video-telefoni, është e nevojshme që personat kontaktues të jashtëm të kenë një lidhje interneti, një pajisje me Skype-softuer të instaluar dhe një llogari të instaluar të përdoruesit dhe që ata të jenë online në datën e caktuar për takim.

1. Grupi i përdoruesve

1.1 Të burgosurit

Vetëm të burgosurit, vizitat e të cilëve tek personat e kërkuar nuk kërkojnë monitorim akustik, lejohen për videotelefoni.

1.2 Personat kontaktues

Për videotelefoni mund të lejohen:

- gruaja ose burri,
- partneri afatgjatë,
- fëmijët tuaj,
- prindërit ose
- persona të tjerë që kanë një marrëdhënie veçanërisht të

denjë për mbështetje të të burgosurit, nëse vizitat nga këta persona mund të realizohen vetëm në kushte të vështira për arsye të

- distancës hapësinore,
- gjendjes së tyre shëndetësore,
- situatës së tyre financiare, ose
- nga shkaqe tjerat ë arsyeshme.

2. Ekzaminimi dhe lejimi për vizitën në Skype

Lejimi për video-telefoninë bëhet në një proces aprovimi, duke marrë parasysh çështjet e sigurisë dhe rregullatorit të institucionit si dhe nevojën për mbështetje dinjitoze për kontaktet e kërkuara. Nëse vërehet se paraburgimi është mbiburgim dhe ekzistojnë kufizime gjyqësore për vizita ose telekomunikim, atëherë kërkohet gjithashtu leja gjyqësore.

3. Deklarata e miratimit dhe dëshmia e identitetit të personit kontaktues

Personi kontaktues duhet të miratoj me shkrim kushtet e përdorimit dhe të përpunimit të të dhënave në gjuhën gjermane. I burgosuri i dërgon personit kontaktues fletën me kushtet e përdorimit dhe formularin për deklaratën e miratimit. Ekziston dhe mënyra alternative, ku të afërmit mund të shkarkojnë dokumentet nga faqja e internetit e JVA Werl (<https://www.jva-werl.nrw.de/infos/index.php>). Në atë faqe gjenden përkthimet në gjuhë të ndryshme për tu

shkarkuar. Personi i kontaktit dërgon deklaratën e miratimit të printuar në gjuhën gjermane, të plotësuar dhe të firmosur, së bashku me një kopje të kartës së tyre të identitetit të vlefshëm, ose një dokument zyrtar të ngjashëm identifikimi (që përmban foto aktuale) për të verifikuar identitetin e tyre në adresën e emailit të mëposhtëm: poststelle@jva-werl.nrw.de. Kopja e dokumentit të identifikimit do të ruhet në mënyrë elektronike vetëm për qëllimet e telefonisë-video përmes Skype. Skeda e dokumentit të identifikimit nuk duhet të tejkalojë 1 MB dhe emaili në tërësi nuk duhet të tejkalojë 6 MB. Tek "Subjekti" i emailit duhet vendosur numri i regjistrimit dhe emri i plotë i të burgosurit.

Nëse personi i kontaktit nuk është ende gjashtëmbëdhjetë vjeç, kërkohet miratimi i një kujdestari ligjor. Një person kontakti nën moshën katërmëdhjetë vjeç mund të pranohet vetëm së bashku me një person kontakti që ka mbushur tashmë moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç.

4. Caktimi i një orari, kohëzgjatja e përdorimit, dhe kushtet e përdorimit

Oraret për video-telefoninë caktohen nga departamenti i vizitave siç caktohen dhe për vizitat afatgjata. I burgosuri mund të përdorë video telefoninë dy herë në muaj. Kohëzgjatja e përdorimit është zakonisht një orë për çdo herë. Problemet teknike ose zvarritjet nuk çojnë në zgjatjen e kohës së përdorimit të lejuar. Nëse është e nevojshme, i burgosuri mund të marrë një termin tjetër alternativ.

Kohët e video-telefonisë nuk llogariten në kontingjentin mujor të vizitave të së burgosurit.

Video-telefonja do të realizohet në zonën e vizitës gjatë kohës së vizitës në Institutin e vuajtjes së dënimit në Werl.

5. Zbatimi

Stafi përgjegjës për vizita krijon lidhjen e internetit përmes një ofruesi të jashtëm. Në orarin e përcaktuar nga zona e vizitës, për të cilin i burgosuri do të jetë njoftuar, do të krijohet lidhja me llogarinë e dhënë të përdoruesit. Në fillim të video-telefonisë me të burgosurin, personi kontaktues e mban dokumentin e tij të identitetit në formatin origjinal, të cilin dhe e ka dorëzuar gjatë kërkesës, në kamerën e internetit për verifikimin e identitetit.

Ekziston një monitorim optik i kontaktit.

Lidhja mund të ndërpritet pas një tërheqje vërejtjeje nëse sjellja e personit kontaktues ose e të burgosuri rrezikon sigurinë ose rendin e institucionit. Nuk tërhiqet vërejtje, nëse është e nevojshme që të ndalohet menjëherë vizita. Në veçanti, një ndryshim i paautorizuar i përdoruesit çon në ndërprerjen e menjëhershme të lidhjes.

Çdo i burgosur që përdor video-telefoninë obligohet të trajtojë me kujdes dhe me vëmendje inventarin dhe pajisjet teknike në dhomën e vizitës.

6. Mbrojtja e të dhënave

Me vendosjen e një lidhjeje përmes Skype, transmetohen të dhënat e të burgosurit si dhe të dhënat e personit kontaktues. Ruajtja e të dhënave nga ana e institucionit nuk realizohet gjatë kësaj kohe.

7. Kohëzgjatja e vlefshmërisë

Pranimi për përdorimin e video-telefonisë përmes Skype vlenë vetëm për Institutin e dënimit në Werl.